

Mijëra njerëz kanë dalë në Baltimorë, Boston, Nju Jork, Uashington dhe qytete të tjera të SHBA-së për të protestuar për vdekjen e një personi me ngjyrë.

Freddie Grey ka vdekur pak ditë më parë, gjatë kohës sa ka qenë në paraburgim në Baltimorë.

Protestuesit kanë bërë thirrje për reforma në procedurat policore dhe për fundin e vrasjeve të pajustificuara.

Debati kombëtar për përdorimin e forcës policore vazhdon që nga vera e kaluar, kur një adoleshent me ngjyrë është vrarë nga policia në Ferguson të Misurit, transmeton Evropa e Lirë.